



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1001/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Dren Rogova, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit IC Consulente SH.P.K, me NUI: ..., me seli në rr.“Gazmend Zajmi” Hyrja 1, Kati 2, nr.14, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B. M. avokat në Gjakovë, kundër debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, me seli në sheshin “Zahir Pajaziti” nr.36, në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1273/2022 të datës 26.05.2023, me datë 17.11.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e autorizuarit të kreditorit IC Consulente SH.P.K, me NUI: ... , me seli në rr.“Gazmend Zajmi” Hyrja 1, Kati 2, nr.14, në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1273/2022 i datës 26.05.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1273/2022 të datës 26.05.2023, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, dhe ka anuluar urdhri përmbarimor P.nr.449/21 të datës 02.06.2021 të Përmbaruesit Privat Fadil Hoxha dhe ka përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ankesë ka paraqitur i autorizuari i kreditori për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale (pretendime të kuptuara nga referati i ankesës), me propozim që të aprovet ankesa në tërësi si e bazuar, aktvendimi i ankimuar të prishe dhe ndryshohet në dobi të kreditorit ashtu që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të vërtetohet në tërësi si i bazuar urdhri përmbarimor P.nr.449/21 i datës 02.06.2021.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur debitori.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e autorizuarit të kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori IC Consulente SH.P.K, me NUI: ..., me seli në rr.“Gazmend Zajmi” Hyrja 1, Kati 2, nr.14, në Prishtinë, me datë 02.06.2021, ka paraqitur propozim për përmbaerim kundër debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, me seli në sheshin “Zahir Pajaziti” nr.36, në Prishtinë, në bazë të dokumenti të besueshëm, faturës nr.0120.13iC të datës 18.11.2020 dhe faturës nr.0120.14iC të datës 18.11.2020, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 11,100.00 €.

Përmbaeruesi privat Fadil Hoxha, duke vepruar sipas propozimit për përmbaerim të kreditorit me urdhrin P.nr.449/21 të datës 02.06.2021, ka lejuar përmbaerimin, duke vlerësuar se faturat e lëshuar nga kreditori i plotësojnë kushtet për përmbaerim. Kundër këtij urdhri përmbaerimor debitori me datë 11.06.2021 ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbaerimor, me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrit për përmbaerim, ngase faturat nuk janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori i përmbaerimit dhe si rrjedhojë faturat e cekura si në propozim nuk kanë tipare të përmbaerueshmërisë. Më tutje ka shtuar se përmbaeruesi duke vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, ka lëshuar urdhrin për përmbaerim duke mos pasur parasysh mbrojtjen e dinjitetit të debitorit, duke tentuar që të përfitojë në mënyrë të kundërligjshme me qëllim të pasurimit pa bazë, andaj ka propozuar që të aprovet prapësimi dhe të anulohet urdhrin për përmbaerim P.nr.449/21 i datës 02.06.2021. Përgjigje në prapësim ka paraqitur i autorizuari i kreditorit me datë 18.06.2021, duke i kundërshtuar të gjitha pretendimet e debitorit në prapësim, me arsyetimin se urdhrin përmbaerimor është lëshuar në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave të cekura në propozim, duke plotësuar të gjitha kushtet ligjore dhe se në këto fatura janë treguar kreditori dhe debitori, si dhe janë shënuar të dhënat lidhur me objektin, llojin, shumën dhe kohën e përmbushjes së detyrimit monetar. Lidhur me pretendimet e debitorit se faturat nuk janë nënshkruar dhe as vulosur, të njëjtat ka theksuar që nuk qëndrojnë ngase nuk është paraparë një detyrim i tillë. Kreditori ka theksuar se debitori e ka pranuar faturën sipas dërgesës me postë rekomande, me datë 01.06.2016 përmes departamentit të tij administrativ si organ kompetent për pranimin e shkresave, andaj ka propozuar që prapësimi të refuzohet në tërësi si i pabazuar, ndërsa urdhrin përmbaerimor të vërtetohet si i bazuar si dhe debitori të detyrohet që të ekzekutojë menjëherë urdhrin që t’i kompensojë kreditorit të gjitha shpenzimet e procedurës përmbaerimore.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1273/2022 të datës 26.05.2023, ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, ka anuluar urdhrin përmbaerimor P.nr.449/21 të datës 02.06.2021 dhe ka përfunduar në tërësi procedurën përmbaerimore, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomik, ka theksuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, në mbështetje të dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së dhe nenit 12 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbaerimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhrin përmbaerimor duhet të anulohet dhe procedura përmbaerimore të përfundojë në tërësi, për arsyes se në rastin konkret fatura nr.0120.13iC e datës 18.11.2020 dhe fatura nr.0120.14iC e datës 18.11.2020, në bazë të së cilave është lejuar urdhrin për përmbaerim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së, për shkak se nuk mund të vërtetohet që faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se faturat janë dorëzuar te debitori, pasi që të njëjtat nuk janë protokolluar në zyrën e pranimit të debitorit - Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit nuk mbajnë vulën e pranimit – protokollimit, si dhe nuk janë

të nënshkruara nga ana e debitorit, nga rezulton se si të tilla nuk janë të përshtatshme për përmbarrim.

Tutje gjykata ka theksuar se ka vlerësuar pretendimin e kreditorit, se faturat në rastin konkret i janë dorëzuar në mënyrë të rregullt debitorit përmes dërgesës postare, mirëpo të njëjtin e vlerësoj si të pabazuar për faktin se nga flet kthimi i dërgesës i datës 05.12.2020, nuk është specifikuar lloji i dërgesës për marrësin - debitorin, me ç'rast nuk mund të dëshmohet në asnjë mënyrë se debitorin ka pranuar me këtë dërgesë faturat e lartcekura. Andaj, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë urdhrin e lejuar nga përmbarruesi privat e ka anuluar dhe ka përfunduar procedurën në tërësi.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parapara me nenin 182 par.2 të LPK-së, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sa i përket pretendimeve për zbatimin e gabuar të dispozitave të procedurës përmbarrimore dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për përmbarrim. Gjykata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se dokumenti i besueshëm-faturat, në bazë të së cilave organi përmbarrues ka caktuar përmbarrimin, nuk i plotësojnë tiparet e përmbarrueshmërisë.

Me dispozitën e nenit 29 paragrafi 1, pika 1.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (LPP) është paraparë realizimi i kërkesës në të holla në bazë të dokumentit të besueshëm, ku si dokument të besueshëm në bazë të kësaj dispozite përcaktohen: *“kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës”*, ndërsa me paragrafin 3 të të njëjtit nen përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po që se në të është treguar kreditori dhe debitorin, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbarrjes së detyrimit monetar”*. Kurse me dispozitën e nenit 20 paragrafi 1.1.17 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2010, për Zbatimin e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, përcaktohet se: *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruaj faturën tatimore”*.

Bazuar në dispozitat e lartcekur, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka pranuar prapësimin me arsyet se urdhri për përmbarrim është lejuar mbi bazën e faturave të cilat nuk paraqesin dokumente të besueshme pasi që të njëjtat nuk janë të pranuar në mënyrë të rregullt, respektivisht nuk janë të vulosura nga ana e debitorit gjegjësisht nga organi kompetent i debitorit. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se fakti se një subjekt, ka lëshuar një faturë tatimore për debitorin dhe të njëjtën e ka dërguar tek debitorin, çka konstatohet edhe nga vula e pranimit të dokumentit nga debitorin, nuk e bënë me automatizëm kreditorin subjekt me të drejtë të arkëtimit të asaj shume në procedurë përmbarrimore.

Kjo gjykatë vlerëson se fakti se debitori si institucion publik pranon dokumente, përfshirë në rastin konkret faturat kontestuese, si dokumente me vulë të pranimit, nuk nënkupton se i ka pranuar faturat si të tilla dhe shërbimin e ofruar të cilat i përmbajnë të njëjtat, respektivisht prestimin sipas faturës. Që fatura të konsiderohet si pranim i rregullt, do të duhej që debitori si palë kontraktuese, apo përfitues i shërbimeve ta pranonte faturën e rregullt me vënien e nënshkrimit nga personi përgjegjës apo i autorizuar. Së këndejmi, kjo gjykatë gjenë se urdhri për përmbarim i caktuar nga përmbaruesi privat është lëshuar në bazë të një propozimi për përmbarim i cili nuk i ka plotësuar kushtet që kërkohen me dispozitën e nenit 38 të LPP-së.

Sipas gjykatës së shkallës së dytë, në rast se pala kreditore pretendon se ka bazë ligjore për kërkimin e borxhit, nuk ka pengesa ligjore që lidhur me këtë të drejtën e saj ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në mbështetje të nenit 208 dhe 209 pika (b) të Ligjit për Procedurës Kontestimore, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurës Përmbarimore u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1001/2023, me datë 17.11.2023.

Gjyqtari,
Dren Rogova